



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe
Zhvillim Rajonal**

RAPORTI I PUNËS PËR SESIONIN PRANVEROR 2018

Korrik 2018

Përmbajtja

Përbërja dhe struktura e Komisionit

- I. Hyrje
- II. Fushëveprimtaria e Komisionit
- III. Aktivitetet e Komisionit
 - a. Mbledhjet e Komisionit
 - b. Shqyrtimi i projektligjeve
 - c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese
 - d. Shqyrtimi i kërkesave/propozimeve të institucioneve publike dhe sektorit privat
 - e. Mbajtja e dëgjimeve publike
 - f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve
 - g. Kontrolli parlamentar
 - h. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit
 - i. Takimet e kryetares, anëtarëve dhe të komisionit
 - j. Aktivitet tjera
- IV. Rezyme e punës së Komisionit

Përbërja dhe struktura e komisionit

Nr. rendor	Emri dhe mbiemri	Pozita	Përkatësia politike
1	Sala BERISHA - SHALA	kryetare	G/P – PDK
2	Dardan SEJDIU ¹	zëvendëskryetar i parë	G/P – PSD
3	Adem Hoxha	zëvendëskryetar i dytë	G/P – LS
4	Liburn ALIU ²	anëtar	G/P – LVV
5	Glauk KONJUFCA ³	anëtar	G/P – LVV
6	Hykmete BAJRAMI	anëtare	G/P – LDK
7	Mimoza KUSARI - LILA	anëtare	G/P – LDK
8	Memli KRASNIQI	anëtar	G/P – PDK
9	Muharrem NITAJ ⁴	anëtar	G/P – AAK
10	Bilall SHERIFI	anëtar	G/P – NISMA
11	Duda BALJE	anëtare	G/P – 6+

¹ Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-166 datë 14.6.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.06-V-006, të datës 3 tetor 2017 për përbërjen e Komisioneve.

² Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-166, datë 14.6.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.06-V-006, të datës 3 tetor 2017, për përbërjen e Komisioneve.

³ Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-166, datë 14.6.2018, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.06-V-006, të datës 3 tetor 2017, për përbërjen e Komisioneve.

⁴ Sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës nr.06-V-180, datë 12.7.2018, deputetin Gani Dreshaj e ka zëvendësuar deputeti Muharrem Nitaj nga GP AAK.

I. Hyrje

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin e mëtejme: komisioni), është Komision FunkSIONAL i Kuvendit të Republikës së Kosovës⁵. Qëllimi i tij është t'i shqyrtojë të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me ekonominë, infrastrukturën, tregtinë, industrinë, energjetikën, transportin, telekomunikacionin etj.

Më qëllim të pasqyrimin të punës së tij në sesionin pranveror 2018 (janar-korrik) të Legjislaturës VI, është hartuar ky Raport, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, që tregojnë për aktivitetet dhe punët që i ka realizuar komisioni gjatë kësaj periudhe, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të marrëveshjes së grupeve parlamentare, komisioni pari në përbërje anëtarë të të gjitha grupeve parlamentare, në bazë të numrit të votave të fituara në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 11 qershor 2017⁶.

⁵ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 69 par. 4.3.

⁶ Shih për këtë tabelën me përbërjen dhe strukturën e komisionit.

II. Fushëveprimi i komisionit

Komisioni në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësiave i shqyrton të gjitha çështjet që përfshijnë:

- Shqyrtimin e projektligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të Kosovës, duke i bërë rekomandime Kuvendit dhe ministrisë përkatëse etj.;
- Krijimin e infrastrukturës ligjore për mjedis më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe që lidhen me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike;
- Angazhimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, të tregtisë, të industrisë dhe të transportit;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrive dhe agjencive-rregullatorë që i raportojnë komisionit, dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe agjencive -rregullatorë të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij komisioni;

Në ushtrimin e funksioneve, komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohej nga komisioni. Komisioni Parlamentar për të marrë informacione shtesë nga grupet e interesit apo aktorët kryesorë për zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjes efektive të politikave, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, organizon dëgjime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ku diskutohet legjislati në interes të zhvillimit ekonomik dhe mënyrat për të nxitur biznesin dhe prodhimin vendor në Kosovë, thithjen e investimeve të huaja, përmirësimin e mjedisit të biznesit, dhe për funksionimin dhe fuqizimin e agjencive dhe rregullatorëve që i raportojnë komisionit.

III. Aktivitetet e komisionit

Komisioni gjatë këtij sesi ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të Planit të tij të Punës, të hartuar gjithnjë duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë⁷. Këto aktivitete komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, mbledhjeve të grupeve të punës, monitorimit të zbatimit të ligjit, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, më qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre.

Duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë, komisioni në fillim të punës së tij, në janar të këtij viti, e miratoi Planin e Punës, në bazë të cilit edhe i zhvilloi aktivitetet e veta.

⁷ Komisionet parlamentare në secilin fillim, pasi ta marrin Strategjinë legjislativë nga Qeveria e hartojnë Planin e Punës për vitin vijues.

a) Mbledhjet e komisionit

Komisioni gjatë sesionit pranveror 2018 të Legjislaturës VI, realizoi gjithsej 28 (njëzetetë) mbledhje të rregullta. *Mbledhjen e tij të parë e mbajti më 16.1.2018*, që është aktiviteti i parë i tij për këtë sesion. *Ndërkaq, mbledhja e fundit e komisionit u mbajt më 25.7.2018*, që është aktiviteti i fundit i komisionit për këtë sesion. Gjatë kësaj periudhe, komisioni në tërësi realizoi 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) aktivitete, me një mesatare prej 10 (dhjetë) aktiviteteve në muaj.

Gjatë punës së vet, komisioni, i zbatoi procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit⁸. Gjithnjë në mbështetje të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i realizoi mbledhjet dhe takimet e tij të rregullta, në të cilat u shqyrtuan rreth 135 (njëqindtridhjetë e pesë) pika të rendit të ditës⁹. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, morën pjesë përfaqësues të ministrive (ministra etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e komisionit ishin publike dhe u monitoruan nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare¹⁰. Punën e komisionit e monitoruan përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, OSBE-së, NDI-së, INDEP, KDI-së, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e komisionit pati hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike.

Në realizimin e punës së vet, komisioni u mbështet nga partnerët e tij. Duke i marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij sesioni, komisioni arriti në masën më të madhe të përmbush Planin e Punës për këtë sesion. Më këtë rast shpreh falënderim për OJQ INDEP, që i përkrahu një numër të madh të aktiviteteve të Komisionit.

b) Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni si organ i Kuvendit, duke zbatuar mandatin e tij, miratimin e ligjeve apo bërjen e ligjeve, gjatë sesionit pranveror, shqyrtoi Projektligjet në kuadër të fushëveprimit e tij.

Gjatë këtij sesioni, Komisioni arriti që falë angazhimit të tij të bëjë të mundur shqyrtimin e 20 (njëzetë) projektligjeve, dhe një Projektstatuti, ndërsa prej tyre janë miratuar nga Kuvendi gjithsej 9 (nëntë) projektligje¹¹; 8 (tetë) projektligje janë proceduar për lexim të dytë në Kuvend, dhe 3 (tre) projektligje janë në procedurë të shqyrtimit, kanë kaluar leximin e parë në Kuvend, si dhe një Projektstatut është në procedurë të shqyrtimit në Komision.

Projektligjet e miratuara në lexim dytë janë si në vijim:

1. Projektligji për Standardizim, 26.1.2018¹²;
2. Projektligji për Shoqëritë Tregtare, 16.5.2018¹³;
3. Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, 30.3.2018;

⁸ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 62.

⁹ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 64.

¹⁰ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 65.

¹¹ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 62.

¹² Data e miratimit në Kuvend në leximin e dytë;

¹³ Data e miratimit pas kthimit nga Presidenti i Republikës, sepse Kuvendi e pati miratuar në lexim të dytë, më 15.3.2018;

4. Projektligji për Pajisjet nën presion, 30.3.2018;
5. Projektligji për Metrologji, 30.3.2018;
6. Projektligji për Kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, 30.3.2018;
7. Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit, 17.5.2018;
8. Projektligji për masat mbrojtëse në importe, 12.7.2018;
9. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020), 23.7.2018.

Projektligjet e proceduara në lexim dytë janë si në vijim:

1. Projektligji për miniera dhe minerale;
2. Projektligji për shërbimet postare;
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shoferi;
4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-0120;
5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;
6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-179 për Transportin rrugor;
7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës;
8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-183 për Transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

Projektligje dhe Projektstatuti në procedurë të shqyrtimit në Komision janë:

1. Projektligji për Produkte të ndërtimit;
2. Projektligji për Eficiencën e Energjisë;
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Automjete;
4. Projektstatuti i Trepçës.

Në lidhje me shqyrtimin e projektligjeve të lartcekura, gjatë këtij sesioni Komisioni formoi 15 (pesëmbëdhjetë) grupe të punës, për secilin Projektligj, apo pako projektligjesh nga një grup të punës. Në grupe punuese janë trajtuar Projektligjet nga aspekti profesional dhe teknik, ku për të cilat kryesuesi i grupit punues, ka ftuar ministrinë e linjës, ekspertë të ndryshëm që kanë marrë pjesë në hartimin e Projektligjit si mori opinionet e shoqërisë civile.

Gjatë shqyrtimit të këtyre Projektligjeve, *Komisioni hartoi dhe miratoi 277 (dyqinde shtatëdhjetë e shtatë) amendamente*¹⁴.

d) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij sesioni shqyrtoi edhe raportet vjetore të agjencive të pavarura, të themeluara nga Kuvendi¹⁵. Komisioni lidhur me këto raporte, në disa raste kërkoi raport shtesë. Komisioni hartoi Raporte me Rekomandime, të cilat ishin temë diskutimi në mbledhje plenare të Kuvendit të Kosovës.

¹⁴ Këtu janë përfshirë amendamentet të cilat janë miratuar nga Komisioni për ato projektligje që e kanë kaluar atë fazë.

¹⁵ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 72.

Në këtë sesion, raportet vjetore të punës të institucioneve raportuese, janë shqyrtuar të gjitha raportet nga ana e Komisionit si vijon:

1. Raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit për Energji.
2. Raporti vjetor i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil;
3. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
4. Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
5. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullativ Hekurudhor;
6. Raporti vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
7. Raporti vjetor i punës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut;
8. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

Prej raporteve të shqyrtuara, Komisioni miratoi 8 (tetë) *Raporte me Rekomandime* dhe njëherësh e miratoi edhe raportin e punës së tyre.

e) Shqyrtimi i kërkesave/propozimeve të institucioneve publike dhe sektorit privat

Komisioni, gjatë kësaj periudhe shqyrtoi kërkesa të institucioneve publike dhe private dhe të gjitha i adresoi në bazë të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit Zyrës së Rregullatorit për Energji, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.07/21, datë 22.12.2017 për Ndërmarrjen “Qendra Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike- Pallati i Rinisë – PRN067, të propozuar nga Qeveria.

f) Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni gjatë sesionit pranveror realizoi gjithsej 3 (tre) dëgjime publike. Dëgjimet publike Komisioni i organizoi në lidhje me projektligjet në procedurë.

Siç u cek edhe me lartë, dëgjimet publike legislative ishin si në vijim:

1. Projektligji për Miniera dhe Minerale (28.3.2018);
2. Projektligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (4.4.2018);
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete (18.7.2018);

g) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni pati parasysh se një prej detyrimeve kushtetuese është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, e jo vetëm nxjerrja e tij.

Gjatë sesionit pranveror Komisioni është në proces të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike.

h) Kontrolli parlamentar

Duke ushtruar mandatin e tij si mbikëqyrës i punës së Qeverisë/Ministrive që i raportojnë Komisionit, ministrat e dikastereve përkatëse apo zëvendësit e tyre janë ftuar për raportim dhe seanca dëgjimore në Komision, varësisht nga tema të cilën e ka trajtuar Komisioni.

Më poshtë kemi listën e raportimeve të ministrive në Komision gjatë kësaj periudhe:

1. Raportim i z.Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit më 23.1.2018, lidhur me pretendimet e Bechtel – Enka, për penalet që kanë derivuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në ndërtimin e Autostradës “Arben Xhaferi”;
2. Raportim i z. Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit më 30.1.2018, lidhur me Projektligjin nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale, Projektligjin nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion, dhe Projektligjin nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
3. Raportim i z.Bajram Hasani, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 7.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit; Projektligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
4. Raportim i z.Rasim Demiri, ministër për Zhvillim Rajonal, në mbledhje të Komisionit më 14.2.2018, lidhur me prioritetet e ministrisë;
5. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 21.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji dhe Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
6. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 27.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
7. Raportim i z.Besnik Beka, zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit më 27.2.2018, lidhur me Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike, për vitin 2015 dhe 2016;
8. Raportim i z. Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 19.3.2018, lidhur me gjendjen në:
9. a) Shoqërinë Aksionare Trepça SH.A.;
10. b) Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SH.A.; dhe,
11. c) Ndërmarrjen Publike Telekomit i Kosovës SH.A.;
12. Raportim i z.Fehmi Mujota, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit, më 16.5.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Pakos së

projektligjeve të Ministrisë së Infrastrukturës për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje;

13. Raportim i z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 12.6.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë;
14. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 26.6.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020), 23.7.2018;
15. Raportim z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 11.7.2018, lidhur me gjendjen në Ndërmarrjen Publike Telekomit i Kosovës SH.A.;

i) Vizitat e komisionit

Vizitat brenda vendit

Gjatë sesionit pranveror 2015, Komisioni i realizoi 4 (katër) vizita brenda vendit, me qëllim që të shoh për së afërmi gjendjen në institucionet dhe subjektet, veprimtaria e të cilave ka të bëjë me fushëveprimtarinë e Komisionit, si vijon:

- Vizitë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, më 7.2.2018;
- Vizitë në Autoritetin e Aviacionit Civil, më 27.2.2018;
- Vizitë në KOSTT, në bashkëpunim me KDI-në, më 22.3.2018;
- Vizitë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më 4.7.2018.

Vizitat jashtë vendit

Komisioni, në vazhden e punës së tij, realizoi edhe anën e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë pjesë në Konferenca rajonale dhe në seminare të Parlamentit Evropian, si dhe në punëtori të ndryshme etj. Kështu, gjatë këtij sesioni realizoi gjithsej 5 (pesë) vizita jashtë vendit, si vijon:

- Më 12 mars 2018, me SECCP- Turqi;
- Më 24 prill 2018, në Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë - Bruksel;
- Më 23-27 prill 2018, në Departamentin për Tregti – SHBA;
- Më 14 maj 2018, takim me kryetarët e Komisioneve Parlamentare për Energji – Bullgari;
- Më 7-8 qershor 2018, në vizitë studimore për Eficiencë të energjisë (GIZ) – Gjermani.

j) Takimet e kryetares, anëtarëve dhe të Komisionit

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësive në mënyrë më efikase, Komisioni organizoi takime duke e shtrirë bashkëpunimin me të gjitha subjektet, siç janë: komisionet parlamentare,

ministrinë përkatëse, përfaqësuesit e agjencive të pavarura, institucione të huaja si dhe me sindikata të punëtorëve etj.

Gjatë sesionit pranveror, u realizuan 11 (njëmbëdhjetë) takime si në vijim:

- Më 30.1.2018, takim i kryetares me përfaqësues të Ministrisë Federale të Gjermanisë;
- Më 19.1.2018, takim i GP për Projektligjin për Shoqëritë Tregtare, me Odat ekonomike;
- Më 2.2.2018, takim i Komisionit me përfaqësues të Departamentit për Tregti të SHBA-së;
- Më 16.2.2018, takim i kryetares me zv.ambasadoren e Kanadasë;
- Më 21.2.2018, takim i zv. kryetarit Dardan Sejdiu me ekspertë anglezë për konkurrencë;
- Më 27.2.2018, takim i kryetares me ekspertë holandezë, projekti për mbështetje Kuvendit;
- Më 6.3.2018, takim i kryetares me OJQ “Dplus”;
- Më 19.3.2018, takim i kryetares me OJQ “Lens”;
- Më 20.3.2018, takimi/pjesëmarrje e kryetares në Forumin e Lartë për Energji;
- Më 8.5.2018, takim i Komisionit me delegacionin nga Iowa;
- Më 8.5.2018, takim i Komisionit me përfaqësues të Bankës Botërore;
- Më 18.5.2018, takim i Komisionit me biznesmenë të diasporës;
- Më 28.5.2018, takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë të Parlamentit Kroat;
- Më 13.6.2018, takim i kryetares me OJQ “Dplus”;
- Më 13.6.2018, takim i kryetares me Sindikatën e Trepçës;
- Më 26.6.2018, takim i Komisionit me CESS Projekti për mbështetje të Kuvendit;

k) Aktivitetet tjera

Anëtarë të Komisionit gjatë kësaj periudhe, morën pjesë nëpër tryeza dhe konferenca të organizuara nga organizata apo institucione të ndryshme, në të cilat u trajtuan tema të ndryshme nga fushëveprimtaria e Komisionit.

IV. Rezyme e punës së komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	28
2	Numri i pikave të rendit të ditës	135
3	Procesverbale të hartuara	28
4	Projektligje të shqyrtuara dhe të amendamentuara	17
5	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në Komision	3
6	Projektligje të tërhequra nga Qeveria (rendi i ditës)	///
8	Numri i formuar i grupeve punuese	15
9	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	19
10	Numri i amendamenteve të propozuara	277
12	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	17
13	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	///
14	Numri i Rekomandimeve	29
15	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	8
16	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	4
17	Numri i vendimeve të Komisionit	12
18	Vizitat e realizuara jashtë vendit	5
19	Vizitat e realizuara brenda vendit	4
20	Dëgjime publike	3
21	Monitorimi i ligjeve	///
22	Tryeza	///
22	Punëtori/Workshop	1

Raportin e përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit¹⁶

¹⁶ Stafi mbështetës i Komisionit, punoi në këtë përbërje: Armend Ademaj, koordinatori i Komisionit, Muhamet Morina dhe Besim Haliti, zyrtarë të lartë të fushës, Veton Raci, zyrtar ligjor dhe Nurie Morina, nëpunëse administrative.